

Njoftim për shtyp

Sofie, 8 marsim 2013

Konkurs frankofon me titull Ndhmoni planetin !

Konkursi « Ndhmoni planetin ! » bëhet në kuadrin e veprimtarive të Organizatës Ndërkombëtare të Frankofonisë (OIF) në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm dhe të mbrojtjes së ambientit. Shqetësimet mbi të ardhmen e planetit tonë të shprehura veçanërisht në konferencën e Rio+ bëjnë thirrje për një sjellje të përgjegjshme nga pikëpamja ekologjike. Idetë ekologjiste të rinjve që mësojnë frëngjisht në vendet e Evropës qendrore dhe lindore (PECO) të shprehura përmes posterave të tyre, do të shërbejnë për një sensibilizim më të mirë për vlerat e Frankofonisë.

Konkursi u drejtohet të gjithë të rinjve (nga 18-23 vjeç) të pasionuar pas artit grafik, artit ilustrues, kolazhit dhe fotografisë duke u dhënë lirinë për të shpalosur imagjinatën dhe për të shprehur idetë e tyre në formën që dëshirojnë. Kandidatët duhet t'i japin përgjigje pyetjes : « Si e imagjinoni ju të ardhmen e planetit tonë ? » duke krijuar një poster me një tekst në gjuhën frënge. Nuk është parashikuar asnjë kufizim për sa i përket mjeteve të dizajnit që do të përdoren në interpretimin dhe shprehjen e temës së konkursit

Kandidatët duhet të kenë njohuri në gjuhën frënge dhe të jenë rezidentë në një nga gjashtë vendet anëtare të CREFECO-s (Shqipëri, Armeni, Bullgari, Ish-Republika jugosllave e Maqedonisë, Republika e Moldavisë, Rumania). Projektet duhet të dorëzohen para 15 prillit 2013.

Çmimet për fituesit janë : udhëtim gjuhësor trejavor në Zvicër, në Universitetin e Gjenevës – Shtëpia e Gjuhëve ; udhëtim gjuhësor dyjavor në Francë, në CAVILAM-Aleanca franceze, dhurata të shumta si libra nga seria belge e librave me vizatime, etj.

Ju mund të gjeni të gjitha informacionet në sitin internet të Qendrës rajonale frankofone për Evropën qendrore dhe lindore (CREFECO) : www.crefeco.org

Organizata Ndërkombëtare e frankofonisë (OIF) numëron 57 shtete dhe qeveri dhe 20 vëzhgues. . vzwww.francophonie.org

Kontakte : CREFECO, 21, rue Montevideo, étage 3, Sofia 1618, Bulgarie
Tel. : (+359 2) 955 59 71; (+359 2) 489 48 45, Fax: (+359 2) 955 59 77
email : info@crefec.org